

**APLIKIM PËR AKT MIRATIMI  
PËR VEPRIMTARINË E BURIMEVE TË RREZATIMEVE JOJONIZUESE  
PËRDORIM**

Amendim

- Personi juridik/ fizik: \_\_\_\_\_  
Emri, Mbiemri (përfaqësuesi ligjor) \_\_\_\_\_  
Adresa \_\_\_\_\_  
Adresa ku kryhet veprimtaria, nqs është e ndryshme nga më sipër  
\_\_\_\_\_  
Tel \_\_\_\_\_  
E-mail \_\_\_\_\_  
Ekstrakti i rregjistrimit në QKB \_\_\_\_\_
- Paraqit numrin e aktit të miratimit nga KMR \_\_\_\_\_
- Paraqit të dhëna mbi ekspertin e njohur nga KMR.  
Emër/mbiemër \_\_\_\_\_

Dokumenta për tu ngarkuar në sistem sipas renditjes

1. Çertifikatën e konformitetit të pajisjeve për çdo pajisje të re sipas sqarimit në pikën nr.1
2. Raportin vlerësues të shpërndarjes së rrezatimit jojonizues sipas sqarimit në pikën nr.2

Personi fizik/juridik mban përgjegjësi të plotë për vërtetësinë e të dhënavët në aplikim.

I gjithë dokumentacioni të jetë i skanuar në format pdf me ngjyra .

Aplikimi i plotësuar në mënyrë të parregullt dhe jo të plotë do të sjellë vonesa për aplikuesin për akt miratimi. Bazuar në pikën 4.9 të VKM Nr.743 datë 16.10.2012 “Për mbrojtjen e publikut nga rrezatimet jojonizuese” e ndryshuar Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi vendos për ndryshimin e akt miratimit jo më vonë se 60 ditë pune nga data e aplikimit .

Në rast se aplikimi ka pasaktësi dhe mungesa në dokumentacion, bazuar në nenin 91/3 të Kodit të Pr. Administrative, afati për shqyrtimin e aplikimit fillon nga paraqitja e plotë e dokumentacionit.

Format shpjegues për plotësimin e aplikimit për akt miratimi për përdorim të burimeve të rrezatimit jojonizues  
Amendim

Pika 1- Të paraqitet një kopje e çertifikatës së konformitetit të pajisjeve gjeneruese të rrezatimit lëshuar nga autoriteti përkatës dhe i njohur në Republikën e Shqipërisë sipas legjislacionit në fuqi.

Pika 2- Studimi për vlerësimin e shpërndarjes së rrezatimit jojonizues të bëhet nga një ekspert i njohur nga Komisioni i Mbrotjes nga Rrezatimet (KMR) sipas procedurës së vlerësimit të aplikimit për njohje nga KMR si ekspert i kualifikuar për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese Nr. 3618/3 datë 13/05/2014. Të përgatitet me shkrim nga ana e ekspertëve raporti mbi shpërhapjen e rrezatimit jojonizues në përputhje me dokumentin e miratuar nga KMR, Nr. 822/2 datë 13/02/2013, mbi metodikën e llogaritjes së përmasave të zonës kritike të shpërhapjes së rrezatimit, si dhe dokumente të tjera të miratuara nga ana e KMR-së. Ky raport duhet të jetë i firmosur në çdo faqe nga eksperti dhe nga personi fizik/juridik.

Në rastet e stacioneve bazë të përbashkëta, të deklarohet në faqen e parë të rapportit të vlerësimit të shpërndarjes së fushës së rrezatimit elektromagnetik rrëth stacionit për secilin person fizik/juridik nëse ka apo jo ndryshime të fushës elektromagnetike rrëth stacionit.

Në çdo faqe të rapportit të jetë e vendosur vula lidhëse e personit fizik/juridik.

Ekspertiza duhet të paraqesë gjeometriskisht pozicionin e celit (celeve) të një stacioni bazë, të një operatori tjetër në mastin/kullën të ngritur në çati-tarracë/tokë të burimeve të tjera të rrezatimeve jojonizuese, kur celet janë në distancë më të vogël se 50m me celet e stacionit bazë në raport.

Raporti vlerësues duhet të ketë një renditje metodike të paraqitjes të kërkesave rregullatore në raport. Raporti duhet të reflektojë kërkesat e mbrojtjes së publikut në përputhje me rregulloren Nr. 743 dt. 16.10.2012, si më poshtë.

Të paraqitet ambienti/tet ku kryhet veprimtaria me burime rrezatimi jojonizues.

Të paraqiten të dhëna të sakta mbi topografinë e instalimit të stacionit bazë për të cilin kërkohet akt miratim. Të jepet një përshkrim i saktë i pozicionit të stacionit bazë koordinatat gjeografike të paraqiten në formën  $xx^\circ$ (grade)  $xx.x$  '(minuta)  $xxx.xx$ " (sekonda), ndërtesave dhe objekteve rrëth stacionit duke përfshirë distancat, katet dhe lartësitë e objekteve. Ky përshkrim të jepet në një planimetri format A3 dhe në një shkallë 1:200. Kjo planimetri të paraqesë pozicionet e instalimit të masteve dhe celeve dhe azimutet e emërtuara.

Të paraqiten foto prezantuese të antenës, stacionit bazë dhe pozicionit të kullës (në tokë) dhe mastit (në tarracë-çati etj) si dhe objekteve dhe ndërtesave rrëth stacionit.

Përpala aplikimit për akt miratimi, operatorët të sigurojnë nëse ka hapësirë të mëtejshme për të shtuar frekuencia të reja në atë zonë, brenda limiteve rregullatore.

Eksperti duhet tē paraqesë nē raport:

- Tipet e antenave tē instaluara.
- Lartësinë e pozicionimit tē burimit tē rrezatimit jojonizues.
- Fuqitë nē hyrje nē çdo cel pér çdo bandë dhe bandat e frekuencave tē operimit.
- Koeficientin e amplifikimit nē lobin qendorr tē antenës dhe koeficientin e amplifikimit nē lobin dytësor më tē madh (tē nxjerra nga tē dhënat e pasaportës së antenës).
- Azimutin e çdo celi.
- Përkuljet mekanike dhe elektrike tē çdo celi.
- Këndi i hapjes vertikale tē tufës së çdo celi.
- Lartësinë e pikës mbi tē cilën janë bërë llogaritjet.
- Nëse ka cele tē afërtë që ndikojnë nē vlerësim, duhet tē përcaktojë shtrirjen hapësinore tē zonës kritike rezultante.
- Të përcaktohet se fusha rezultante nuk kalon nivelin e referencës sipas legjislativit.
- Të bëhet paraqitja grafike e zonës kritike nē planet xOz pér çdo cel dhe kur ka elemente ndërhyrës nē drejtimet e tjera tē jepen edhe sipas xOy dhe yOz, ose tē jepen koordinatat e projeksioneve tē pikave ekstreme tē zonës kritike.

Eksperti nē vlerësimin e tij duhet tē marrë nē shqyrtim parametrat me tē cilët bëhet ekspozimi maksimal, pér skenarin më tē keq tē mundur i cili rezulton nē favor tē mbrojtjes së publikut.

Nëse ka cele tē afërtë tē kompanive tē tjera nē distancë më tē vogël se 50m nga celet e stacionit nē vlerësim, eksperti duhet tē marrë nē konsideratë zonën kritike rezultante. Në rastin kur nuk është e mundur gjetja e tē dhënavë tē stacioneve tē tjera fqinje, eksperti përdor tē dhëna nē dobi tē publikut, duke konsideruar pér stacionet bazë fqinje fuqitë maksimale tē lejuara pér operim nga Autoriteti Komunikimeve Elektronike e Postare (AKEP).

Mosdeklarimi i tē dhënavë tē sakta tē stacionit dhe gjeneratorëve tē burimeve tē rrezatimit jojonizues, që implikojnë fushën e përhapjes së stacionit, mbenen përgjegjësi e personit fizik/juridik.

Në çdo vlerësim pér akt miratimi eksperti duhet tē provojë me shkrim, se përmasat e zonës kritike rezultante janë tē tillë, që nuk prekin zonat publike dhe janë nē përputhje me VKM, Nr.743, datë 16.10.2012, Rregullore “Pér mbrojtjen e publikut nga rrezatimet jojonizuese”

Pér realizimin e raport ekspertizës referoju faqes zyrtare, <http://www.ishp.gov.al/të-përgjithshme/> ku përcaktohet lista e personave/institucioneve tē njojur nga KMR pér realizimin e raportit/ekspertizën pér mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese.